

MAROK Nisje: • 28 Nëntor

DESTINACIONI

Marok

PERIUDHA

Festat e Nëntorit '2026

KOHËZGJATJA

5 Ditë

TRANSPORTI

Me Avion

PËRMBLEDHJE



FESTAT E NËNTORIT 2026



Nisje 28 Nëntor - Kthim 2 Djetor

- 5 Ditë / 4 Netë
- Çmimi: **799€**
-  Nisja: 08:30 (Tiranë) → 09:55 (Romë)
-  Nisja: 19:15 (Romë) → 21:55 (Marakesh)
-  Kthimi: 08:10 (Marakesh) → 12:35 (Milano)
-  Kthimi: 18:50 (Milano) → 20:45 (Tiranë)

1

ROMË - MARAKESH

DITË

Paraqitja në aeroportin e Tiranës minimumi 2 orë përpara nisjes dhe prezantimi me guidën.

Fluturimi direkt Tiranë – Romë (1 orë : 20 minuta)

Pas mbërritjes në Romë transferata në një ndër qendrat tregtare më të mëdha të Italisë, Parco Commerciale Da Vinci.

Kohë e lirë për shopping, kafe dhe për të konsumuar drekën.

Kthimi në aeroportin e Fiumicinos.

Pas procedurava doganore, fluturimi direkt për në Marok.

Mbërritja në Marakesh në mbrëmje.

Akomodimi në hotel. Fjetja në Marakesh

2

MARAKESH

DITË

Pas mëngjesit, nisja për një **tur të plotë ditor në Marrakech**.

Paradite: Vizitë në **Medersa Ben Youssef**, një nga monumentet historike më të veçanta të Marrakech-it, e ndjekur nga vizita në **Xhaminë Koutoubia**, simboli më i njohur i qytetit.

Dreka: Drekë në një restorant lokal.

Pasditë: Vazhdimi i vizitës në **Medina**, qytetin e vjetër historik të Marrakech-it, më pas në **Sheshin Jemaa el-Fna** dhe në **souk-et (pazaret) e famshme**, ku mund të njiheni me artizanatin tradicional, erëzat, tekstilet dhe produktet tipike marokene.

Pas përfundimit të vizitave, kthimi në hotel.

Fjetje në Marakesh.

Pas mëngjesit, nisja për një **ekskursion të plotë ditor në Essaouira**, qyteti i bukur bregdetar i njohur për medinën piktoreske, portin tradicional dhe atmosferën e tij të qetë.

Pas mbërritjes, vizitë në atraksionet kryesore të qytetit dhe kohë e lirë për të eksploruar **Medinën dhe portin e Essaouira-s**.

Dreka: Drekë në një restorant lokal.

Pasdite, nisja për kthim në **Marrakech**.

Mbrëmja: Pjesëmarrje në spektaklin e paharrueshëm **Fantasia në Chez Ali**, me muzikë tradicionale marokene, folklor, shfaqje spektakolare dhe një **darkë autentike marokene**.

Pas përfundimit të spektaklit, kthimi në hotel.

Fjetje në Marakesh.

Pas mëngjesit, nisja nga **Marrakech** për një ekskursion panoramik drejt **Luginës së bukur Ourika**, e vendosur në rrëzë të **Maleve Atlas**.

Gjatë ekskursionit do të shijoni peizazhet e mrekullueshme natyrore, do të njiheni me **fshatrat tradicionale berbere** dhe atmosferën autentike të kësaj zone të Marokut.

Dreka: Drekë në një restorant lokal, me pamje nga peizazhet e Luginës Ourika.

Pas dreke kthimi në hotel.

Pasdite e lirë.

Fjetje në Marakesh.

Transferta mëngjes herët për në aeroportin e Marakeshit.

Fluturimi direkt Marakesh – Milano Malpensa.

Kohë e lirë në aeroportin e Malpensës.

Fluturimi direkt Malpensa – Tiranë.

Mbërritja në Tiranë pasdite.

✓ PËRFSHIHET

- ✓ Fluturimi me avion Tiranë - Romë - Marakesh / Marakesh - Milano - TiranëAkomodimi në hotel 4★ në Marrakech, me mëngjes, për 4 netë Transporti me autobus turistik gjatë gjithë programit Transfertat Aeroporti Marrakech – Hotel – Aeroporti MarrakechGuidë anglishtfolëse gjatë ekskursioneve të parashikuara në program: City Tour në Marrakech dhe ekskursion në Essaouira, me dreka në restorante lokale Mbrëmja Magjike Fantasia në Chez Ali, me darkë dhe spektakël tradicional liveEkskursion në Luginën Ourika, me drekë të përfshirëShoqëruesh shqiptar gjatë 5 ditëve të turitBiletat e hyrjes në monumente sipas programiTaksat lokaleLejohet të merret me vete në avion vetëm një çantë me përmasa 40cm x 30cm x 20cm deri në 10 kg. (Kujdes – Mbi këto përmasa dhe Bagazh për checkin ka shpenzime ekstra).

× NUK PËRFSHIHET

- × Dreka ditën e parë në Romë dhe ditën e pestë në MilanoDarkat (pervecse darkën me muzike ditën e tretë që është e përfshirë)

VENDTAKIMI I NISJES

- Nga aeroporti Nënë Tereza, ku duhet të paraqiteni minimumi 2 orë përpara

POLITIKAT E ÇMIMIT PËR FËMIJËT

- Fëmijët në moshën 2 – 11.99 vjeç përfitojnë 60€ zbritje nga cmimi i paketës

Shenim: Kjo politike hyn në fuqi vetëm nëse fëmijët akomodohen në dhomë me 2 të rritur.

DOGANA

- 1) Pashaportë me vlefshmëri minimumi 3 muaj
- 2) Nuk duhet të keni kaluar në 6 muaj e fundit më shumë se 90 ditë qëndrimi në vendet e BE

INFORMACIONE

- Akomodimi në dhomë teke (single) është me ekstra pagesë në vlerën 50% mbi çmimin për person.
 - Nëse krevati nuk do të jetë dopio, atëherë do të jenë dy krevatë teke të bashkuar.
 - Nëse shtrati për personin e tretë/katërt nuk do të jetë standart, atëherë do të jetë sofa bed (shtrat i shtuar në dhomë).
 - Operatori Turistik nuk mban përgjegjësi për personat e kthyer nga policia për arsye të ndryshme sic janë mungesë dokumentacioni, ekspuls, skadenca e mjetit identifikues, etj.
 - Nëse nuk i keni mbushur 18 vjeç dhe udhëton pa praninë e njërit ose asnjërit prej prindërve, ju nevojitet prokurë e noterizuar në gjuhën angleze.
 - Ekziston mundësia që disa nga përmbajtjet e hotelit/udhëtimit të mos jenë aktualisht në funksion për shkak të rrethanave objektive, të cilat operatori nuk mund të ndikojë.
 - Cmimet dhe disponueshmëria e muzeumeve, ekskursioneve dhe cdo aktivitet tjetër lokal mund të ndryshojnë dhe janë përgjegjësi e vetë Operatorëve Lokale që mundësojnë këto shitje.
- Për cdo ndryshim në lidhje me këto aktivitete, klienti lajmërohet përpara kryerjes së shërbimit.
- Kujdesi ndaj sendeve personale gjatë qëndrimit në aeroplan, autobuz, traget, është përgjegjësi individuale e klientit dhe jo e Operatorit

DESTINACIONI	Marok
TRANSPORTI	Me Avion
ÇMIMI	€799.00 / person
ZBRITJE FËMIJË	99% (€8.00)
GJENERUAR	16/09/2026 08:16